

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISE "ESSENTI HEALTHCARE" SHPK

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

Me kete akt themelimi, sot ne daten 03.08.2021, Ortaket:

Evaristo Demiraj, i biri i Hysen, i datelindjes 01.02.1988, shtetesia Gjermane, banues ne Rruga Pillingser Weg 9, Kodi postal 58644, Iserlohn, Gjermani, identifikuar me ane te kartes se identitetit nr. L7NJJ42F9.

Elson Jaçaj, i biri i Ismail, i datelindjes 29.05.1984, shtetesia Shqiptare, banues ne rruga Muhamet Gjollesha, pallati 42/1, shkalla 3, apartamenti 28, Tirane, Shqiperi, identifikuar me ane te kartes se identitetit nr. 035537483 nr. Personal I40529063I.

deklarojne se:

1. Vendosen te themelojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar emertuar "ESSENTI HEALTHCARE" SHPK, aktiviteti i se ciles do te rregullohet sipas ketij Akt Themelimi, Statutit bashkelidhur dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqeria "ESSENTI HEALTHCARE" SHPK eshte person juridik i se drejtes shqiptare dhe si i tille do te filloje aktivitetin e saj pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.


Kohëzgjatja e aktivitetit te shoqërisë është vendoset për një periudhe te pacaktuar.

2. Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare "ESSENTI HEALTHCARE" SHPK eshte:

1. Ofrimi i sherbimeve te konsulences,
2. Zhvillimi i trajnimeve,
3. Zbatimi i projekteve,
4. Ofrimi i burimeve njerezore te specializuara, ne fushen e infermierise, mjeksise, etj.

Objekti i shoqerise mund te ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Per permbushjen e objektit te veprimtarise, shoqeria mund te marre pjese ne ndermarrje apo shoqeri te tjera qe kane objekt te njejte ose te perafert me te sajine dhe mund te kryeje direkt apo indirekt te gjitha veprimet tregtare, financiare, me karakter te luajtshem e te paluajtshem.



Shoqeria mund te hape dhe te mbaje llogari rrjedhese ne leke apo monedha te tjera, prane bankave shqiptare apo te huaja, duke mundur gjithashtu te disponoje lirisht mjetet monetare te akumuluar ne to, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

3. Zyra qendrore e shoqerise eshte ne adresen: Hotel Rimini, Dhoma nr. 10, Njësia Administrative Nr. 5, Rruga "Adem Jashari nr 10", Objekt privat Nr. 10, Zona Kadastrale 8270, Nr. Pasurie 5/327, Volumi 36, Faqe 201, Tirane, Shqiperi.

Adrese email: evaristo@essenti.de.

Numer telefoni: +49 1578 5522446

Shoqeria mund të vendosi hapjen e vendeve te tjera te ushtrimit te aktivitetit, degëve dhe zyrave te perfaqesimit, brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

4. Kapitali themeltar perbehet nga 2 (dy) kuota dhe vlere totale e kapitalit eshte 100,000.00 (njeqindmije) leke, nga te cilat: ne kontribute ne para vlere eshte 100,000.00 (njeqindmije) leke. Kuota ne perqindje e ortakeve ne kapitalin themeltar te shoqerise jane:

Evaristo Demiraj, zoteron 51% te kapitalit, 1 kuote me vleren 51,000.00 (pesedhete e njemije) leke.

Elson Jaçaj, zoteron 49% te kapitalit, 1 kuote me vleren 49,000.00 (dyzete e nentemije) leke.

Kapitali fillestar i nenshkruar nuk eshte paguar dhe kontributet ne para do te paguhen plotesisht pas regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit.

5. Administrimi dhe perfaqesimi i shoqerise i besohet Administratorit, qe mund edhe te mos jene ortak. Administratori emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte ripertesitjeje, Mandati i administratorit mund te perfundoje perpara ketij afati ne rast doreheqje apo shkarkimi nga ana e Asamblese.

Administrator i shoqerise caktohet Evaristo Demiraj, i biri i Hysen, i datelindjes 01.02.1988, shtetesia Gjermane, banues ne Rruga Pillingsser Weg 9 Kodi postal: 58644, Iserlohn, Gjermani, identifikuar me ane te kartes se identitetit nr. L7NJJ42F9.

Kompetencat e administratorit dhe menyra e ushtrimit te tyre do te rregullohen nga statuti dhe ligji.

6. Viti ekonomik fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

7. Ne nje liber te posacem te shoqerise shenohet kapitali shoqeror dhe vlere e kontributeve me kuotat relative per secilin ortak.

Ortakët mund ta zmadhojne kontributin e tyre dhe si pasoje edhe kouten e tyre, duke transferuar fitimet nga aktiviteti shoqerise, ne perputhje me pershkrimin ne Statutin e shoqerise.

8. Ne perfundim te vitit ekonomik, pas aprovimit te bilancit, Asamblea mund te vendose ndarjen e fitimit (dmth, pasi jane ndare fondet per likuidimin e detyrimeve ndaj te treteve, detyrimet fiskale ndaj shtetit, rezervat e detyrueshme) midis ortakeve. Ky fitim mund te transferohet lirish jashte Shqiperise, konform legjislacionit ne fuqi. Per humbjet pergjigjet eskluzivisht shoqeria me kapitalin e saj.

9. Ortaket dhe Administratori jane te detyruar te ruajne sekretin mbi dokumentacionin dhe te dhenat, njohurite dhe eksperiencat e fituara gjate aktivitetit te shoqerise, si dhe marrin te gjitha masat e nevojshme te sigurise per te evituar përhapjen, qofte edhe pjesore te tyre.

Ata jane pergjegjes per pasojat e mundshme negative nga shkelja nga ana e tyre e sa me sipërthene.

Detyrimi dhe pergjegjesia per sa eshte specifikuar ne kete nen, perfshin edhe Ekspertin Kontabel te Miratuar.


Ortaket jane pergjegjes ndaj te treteve per demet qe mund t'u shkaktohen nga anulimi apo deklarimi i pavlefshem i ketij akti themelues.

Per sa nuk specifikohet shprehimisht ne kete akt, zbatohen dispozitat e Statutit.



ORTAKET THEMELUES

TE

SHOQERISE "ESSENTI HEALTHCARE" SHPK



Evaristo Demiraj



Elson Jaçaj

